



BASHKIA  
TIRANË

**Drejtuar: Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Ed Konstruksion” shpk &” ALBA KONSTRUKSION” shpk**

**Adresa:** Rr. Frederik Shiroka, GV-Konstruksion, Kulla C, Kat 2, ap.1/2. Tiranë

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: **”Ndërtim i shkollës 9-vjeçare ”Kosova” Tiranë”**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **”Ndërtim i shkollës 9-vjeçare ”Kosova” Tiranë”**, duke realizuar, ndërtimin e shkollës 9-vjeçare Kosova, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit

Fondi limit: **221.159.169** ( dyqind e njëzetë e një milion e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH**

Burimi i financimit: vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit Nr.16, datë 14.04.2017 për disa ndryshime në vendimin nr.37, datë 13.07.2016, të Komitetit të rajoneve për zhvillimin e rajoneve ”Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit ”Arsim”, thirrja e dytë, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, për vitin 2016

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **datë 09.06.2017 , ora 11:00**

Publikime të mëparshme: *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike datë 22.05.2017**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori Ekonomik “Gjoka Konstruksion” sha** me nr. NUIS J 91815014 U  
Vlera e ofertës pa TVSH = 198.600.198,76( njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion e gjashtëqind mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë presje shtatëdhjetë e gjashtë)lekë.
- 2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Gjiguria” shpk & “R&T” shpk** me nr. NUIS J62903456H &J61901094G  
Vlera e ofertës pa TVSH = **194.597.307** ( njëqind e nëntëdhjetë e katër milion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatë) lekë
- 3. Bashkimi I Operatorëve Ekonomikë “Ed konstruksion” shpk &” ALBA KONSTRUKSION” shpk** me nr. NUIS K61625001I &J61812013R  
Vlera e ofertës pa TVSH = **216.727.812,37**( dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind e njëzetë e shtatë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë presje tridhjetë e shtatë) lekë.

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

## 1. Operatori Ekonomik “Gjoka Konstruksion” sha

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 1 si më poshtë cituar:*

### **Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

#### **1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **110.579.584** (njëqind e dhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.**
- b. punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **442.318.338** (katërqind e dyzetë e dy milion e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH.**

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

#### **2. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me:
  2. Kontratë
  3. Situacionin përfundimtar;
  4. Aktin e kolaudimit;
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me:
  2. Kontrate;
  3. Situacionin përfundimtar;
  4. Akt kolaudimi objekti;

## 5. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Shoqëria Gjoka shpk ka paraqitur elektronikisht për të përmbushur kriterin e mësipërm kontratat si më poshtë:

1- Kontrata me nr. Prot 8802/4 e datës 31.01.2011 me objekt “Ndërtim Rruga e Arbrit”(dalje Ura e Vashës-Bulqizë) Loti III me vlerë të saj pa TVSH 1.324.658.901,30 ( një miliard e treqind e njëzetë e katër milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e një presje tridhjetë ) lekë.

Nga analiza e bërë vemë re se shoqëria Gjoka Konstruksion sha ka paraqitur për të vërtetuar përvojën e suksesshme në punë si kontratë të ngjashme , kontratën e mësipërm e cila nuk konsiderohet **kontratë e ngjashme** pasi kemi të bëjmë me infrastrukture rrugore dhe nuk kemi të bëjmë me godina civile ashtu dhe siç është objekti i prokuruar nga AK ,

Pra sa më sipër cituar shoqëria Gjoka Konstruksion sha nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket **Përvojës së suksesshme në realizimin e Kontratave pune të ngjashme për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi** duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 1/a dhe pika 1/b, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

- *Gjithashtu AK në dokumentat Standarte te Tenderit ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:*

5.1 Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit të pakten **37(tridhjetë e shtate ) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të**, ku nga keta te jene te pakten:

- 3 (tre) punonjës (manovrator) **me kategori II**
- 28 (njetete e tete) punonjës nga të cilët 3 (tre) bojaxhinj, 3(tre) saldator, 3 (tre) hidraulik, 3 (tre) elektromekanik, 2 (dy) karpentier, 2 (dy) hekurkthyes, 4 (kater) murator, 5 (pese) puntor ndertimi, 3 (tre) pllakashtrues **me kategori të III**
- 3 (tre) punonjës elektrikistë **me kategori të IV**
- 3 (tre) punonjës elektrikistë **me kategori të V**

Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatëse te kualifikimit te sigurimit teknik, kontrata e punës e vlefshme, për manovratorët duhet të paraqesin gjithashtu dhe dëshmitë e drejtimit (të vlefshme) nga të cilat një dëshmi të jenë për automakinistë dhe dy të tjerat eskavatoristë, lëshuar nga institucionet përkatëse)

Nga verifikimi në sistem i dokumentave të ngarkuar për kualifikim në procedurën e mësipërme nga Operatori ekonomik “GJOKA KONSTRUKSION” sha rezulton se:

1.AK ka kërkuar 3 (tre) bojaxhinj të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë punonjës bojaxhi të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III 2.AK ka kërkuar 3(tre) saldator të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Operatori Ekonomik ka paraqitur tetë punonjës saldator të cilët janë me kategori të II-të dhe përkatësisht B.M, XH.L, A.P, I.K, O.G, A.Z, A.P, M.H, nuk janë punonjës me kategori të III-të por me kategori të II-të.

3.AK ka kërkuar 3 (tre) hidraulik të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë punonjës hidraulik siç dhe është kërkuar në dokumentat standarte të tenderit.

4.AK ka kërkuar 3 (tre) elektromekanik të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Operator ka paraqitur gjashtë punonjës elektromekanik por asnjëri prej tyre nuk është me kategori të III-të ashtu siç dhe është kërkuar në dokumentat standarte të tenderit dhe përkatësisht punonjësi I deklaruar si elektromekanik me iniciale G.H është me kategori të I-rë, si dhe punonjësit e deklaruar me iniciale B.D, E.SH, G.Z, F.K, G.H nuk janë punonjës me kategori të III-të por me kategori të II-të.

5.AK ka kërkuar 2 (dy) karpentier të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Operator ka paraqitur dy punonjës karpentier me kategori të parë dhe jo të III-të pasi punonjësi i deklaruar si karpentier me iniciale J.M dhe A.T, nuk janë punonjës me kategori të III-të por me kategori të I-rë.

6.AK ka kërkuar 2 (dy) hekurkthyes të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

operatori ka paraqitur vetëm tre punonjës hekurkthyes me kategori të parë dhe jo me kategori të III-të , pasi punonjësit hekurkthyes me iniciale D.M, A.H, D.B nuk janë punonjës hekurkthyes me kategori të III-të por me kategori të I-rë

7.AK ka kërkuar 4 (kater) murator të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Operatori nuk ka paraqitur asnjë punonjës murator

8.AK ka kërkuar 5 (pese) puntor ndertimi të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Operatori ka paraqitur nëntë punonjës ndërtimi me kategori të parë dhe jo me kategori të III-të , pasi punonjësit e ndërtimit me iniciale Xh.K, SH.B, R.M, P.L, K.B, A.S, A.L, E.K,R.K nuk janë punonjës ndërtimi me kategori të III-të por me kategori të I-rë

9.AK ka kërkuar 3 (tre) pllakashtrues të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Operatori nuk ka paraqitur asnjë punonjës pllakashtrues

*Operatori ekonomik “Gjoka Konstruksion” sha, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që AK i vlerëson të nevojshme.....*

*b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.*

***Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të kualifikimit pika 5.1 është I paplotë , për rrjedhojë i pavlefshëm***

- Gjithashtu AK në dokumentat Standarte te Tenderit ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:

5.2 Te kete ne staf te punësuar:

a. Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me “Certifikate per auditimin e energjise)

5.3 (Per inxhinierin e eficenses se energjise duhet te kete keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme per te paktën periudhen e parashikuar te ndertimit), Certifikata (Dip) per eficensen e energjise. Duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë të paktën për 6 (gjashtë) muajt e fundit.)

5.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(nje) Inxhinier Telekomunikacioni, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës .Duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë të paktën për 6 (gjashtë) muajt e fundit.

Operatori Ekonomik “GjokaKonstruksion” sha nuk ka paraqitur një inxhinier audites energjie I cili të jetë I paisur me dokumentat e mësipërme ashtu edhe siç kërkohet në dokumentat standarte të tenderit (Kriteret e veçanta të kualifikimit/Kapaciteti teknik pika 5.2, 5.3)

Gjithashtu nga verifikimin në sistemin elektronik të app-së , komisioni I Vlerësimit të Ofertave konstatoi që operatori ekonomik nuk ka paraqitur inxhinier telekomunikacioni ashtu dhe siç kërkohet në DST (Kriteret e veçanta të kualifikimit/Kapaciteti teknik pika 5.6)

Pra sa më sipër shoqëria “Gjoka Konstruksion” sha nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket **personelit të nevojshëm** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional,pika5.2 , 5.3, pika 5.6, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: **Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....**

- Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e veçanta të kualifikimit / Kapaciteti Teknik si më poshtë cituar:

6. Shoqëria duhet te paraqesë Certifikaten e cilesise se punimeve **ISO 9001- 2008** (e vlefshme). (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten Iso).

7. Shoqëria duhet te paraqesë Certifikate **ISO 14001-2004** (e vlefshme). (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten ISO).

8. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **OHSAS 18001-2007**(e vlefshme)(Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten OHSAS).

9. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **PAS 99-2012**(e vlefshme)(Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten PAS).

10. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO 39001 -2012** (e vlefshme) (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten Iso).

Shoqëria Gjoka Konstruksion ka paraqitur çertifikatat e mësipërme por nga verifikimi i dokumentave të mësipërme rezulton që afati i vlefshmërisë së certifikatave PAS 99-2012 dhe ISO 39001-2012 ka skaduar në datën 02.06.2017 ndërkohë që afati i fundit për pranimin e ofertave për procedurën e mësipërme ka qënë data **09.06.2017**, për rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur prej saj lidhur me çertifikatat është i paplotë.

- Në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 11 citohet:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë ( shtojca 9)

Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri 10 ton për secilin kamion)	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Buldozer	1 copë	Pronësi ose me qera
MotoGjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamioçinë deri në 2 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Mini eskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Betonforma	1500 m2	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri 5 ton per secilin kamion)	2 cope	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Depozitë uji (5000)	1 copë	Pronësi ose me qera
Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rretë mbrojtëse për punime në fasadë)	1500 m2	Pronësi ose me qera
Prerëse Asfalti	2 cope	Pronësi ose me qera
Aparat Saldimi	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike prodhim betoni	1 copë	Pronësi ose me qera

Rul me kompresor per ngjeshje asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Rul me Vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera

Operatori ekonomik “GJOKA KONSTRUKSION” sha ka deklaruar në shtojcën 9 fadroma copë 2 në pronësi . Për njëri nga fadromat dhe respektivisht për fadromën Liebher me goma L564 është paraqitur fatura tatimore me nr.6329 të datës 04.05.2011 si dhe ka paraqitur fadromën me goma volvo L150 për të cilën ka paraqitur faturë shitje me nr.25 datë 12.08.2009

Për mjetet e mësipërme nuk janë paraqitur çertifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit, si dhe leja e qarkullimit rrugor mosplotësimi i këtij kushti bie në kundërshtim me “Kriteret e veçanta për kaulifikim”, kapaciteti Teknik pika 11, gërma (a) ku citohet:

**Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi**

Pra sa më sipër cituar për fadromat e paraqitur nga operatori ekonomik duhet detyrimisht të kishin dokumentacionin shoqëruar Lejë Qarkullimi, Çertifikatë e kontrollit teknik dhe siguracion mjeti.

Operatori ekonomik "Gjoka Konstruksion" sha ka deklaruar në shtojcën 9 eskavator me goma copë 1 në pronësi i paisur me faturë doganore me nr. R3947 dt 03.02.2004. Për eskavatorin me goma shoqëria nuk ka paraqitur lejë qarkullim, çertifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit, C'ka bie në kundërshtim me "Kriteret e veçanta për kualifikim", kapaciteti Teknik pika 11, gërma (a) ku citohet:

**Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi**

Pra sa më sipër cituar eskavatori me goma nuk ka lejën e qarkullimit, Çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion mjeti. Gjithashtu theksojmë se AK ka kërkuar për realizimin e kontratës me sukses paraqitjen e dy eskavatorëve me goma. Operatori ekonomik nuk e ka përmbushur kushtin e mësipërm.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 9 , me pikën 11 është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## **2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "Gjiguria" shpk & "R&T" shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Bashkim Operatorësh Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pika 1 gërma b si më poshtë cituar:*

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

b. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

c. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

ç. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 8;*

d. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9;*

dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Shoqëria R&T ka paraqitur deklaratën mbi konfliktin e interesit por e ka paraqitur pa firmën e administratorit të shoqërisë dhe pa vulën e shoqërisë **për rrjedhojë është paraqitur e pasaktë .**

- *Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e veçanta të kualifikimit / Kapaciteti Teknik si më poshtë cituar:*
6. *Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën e cilesise se punimeve ISO 9001- 2008 (e vlefshme). (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten Iso).*
  7. *Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë ISO 14001-2004 (e vlefshme). (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten ISO).*
  8. *Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë OHSAS 18001-2007(e vlefshme)(Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten OHSAS).*
  9. *Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë PAS 99-2012(e vlefshme)(Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten PAS).*
  10. *Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 39001 -2012 (e vlefshme) (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten Iso).*

*Shoqëria Gjiguria Konstruksion ka paraqitur certifikatën ISO 9001- 2008 por nga verifikimi i dokumentave të mësipërme rezulton se certifikata e mësipërme është në gjuhën angleze.*

*Në dokumentat Standarte te Tenderit tek njoftimi i kontrates gjuha e përzgjedhur nga AK është gjuha shqip për sa më sipër të gjithë dokumentat duhet të dorëzohen në gjuhën shqip.*

*Gjithashtu në fund të kriterve të veçanta të kualifikimit citohe si më poshtë:*

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

***Për rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur prej saj lidhur me certifikatat është i paplotë.***

- *Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në pikën 5.1 si më poshtë cituar:*

5.1 Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit të pakten 37(tridhjetë e shtate ) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

- 3 (tre) punonjës (manovrator) me kategori II
- 28 (njetete e tete) punonjës nga të cilët 3 (tre) bojaxhinj, 3(tre) saldator, 3 (tre) hidraulik, 3 (tre) elektromekanik, 2 (dy) karpentier, 2 (dy) hekurkthyes, 4 (kater) murator, 5 (pese) puntor ndertimi, 3 (tre) pllakashtrues me kategori të III
- 3 (tre) punonjës elektrikistë me kategori të IV
- 3 (tre) punonjës elektrikistë me kategori të V

Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatëse te kualifikimit te sigurimit teknik, kontrata e punës e vlefshme, për manovratorët duhet të paraqesin gjithashtu dhe dëshmitë e drejtimit (të vlefshme) nga të cilat një dëshmi të jenë për automakinistë dhe dy të tjerat eskavatoristë, lëshuar nga institucionet përkatëse)



Nga verifikimi në sistem i dokumentave të ngarkuar për kualifikim në procedurën e mësipërme nga Bashkimi i Operatorëve rezulton se:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë ka paraqitur 3 (tre) bojaxhinj, 3(tre) saldator, 3 (tre) hidraulik, 3 (tre) elektromekanik, 2 (dy) karpentier, 2 (dy) hekurkthyes, 4 (kater) murator, 5 (pese) puntor ndertimi por nuk I ka në kategorinë e kërkuar nga AK. Kategoria e kërkuar nga AK është kategori e tretë persa I përket Bashkimit të operatorëve ka deklaruar si më poshtë:

1.AK ka kërkuar 3 (tre) bojaxhinj të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Bashkimi I operatorëve kanë paraqitur tre punonjës bojaxhinj me kategori të parë dhe përkatësisht punonjësit me iniciale K.B, A.Sh, I.A

Punonjësit e mësipërm nuk janë punonjës me kategori të III-të por me kategori të I-rë.

2.AK ka kërkuar 3(tre) saldator të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Bashkimi I operatorëve kanë paraqitur tre punonjës saldator me kategori të dytë dhe përkatësisht punonjësit me iniciale Z.L, L.XH, P.K

Punonjësit e mësipërm nuk janë punonjës me kategori të III-të por me kategori të II-të.

3.AK ka kërkuar 3(tre) hidraulik të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Bashkimi I operatorëve kanë paraqitur tre punonjës hidraulik me kategori të dytë dhe përkatësisht punonjësit me iniciale A.Gj, S.T, J.K

Punonjësit e mësipërm nuk janë punonjës me kategori të III-të por me kategori të II-të.

4.AK ka kërkuar 3(tre) elektromekanik të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Bashkimi I operatorëve kanë paraqitur tre punonjës elektromekanik me kategori të dytë dhe përkatësisht punonjësit me iniciale U.T, D.Z, P.K

Punonjësit e mësipërm nuk janë punonjës me kategori të III-të por me kategori të II-të.

5.AK ka kërkuar 2(dy) karpentier të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Bashkimi I operatorëve kanë paraqitur dy punonjës karpentier me kategori të parë dhe përkatësisht punonjësit me iniciale A.B, A.A

Punonjësit e mësipërm nuk janë punonjës me kategori të III-të por me kategori të I-rë.

6.AK ka kërkuar 2(dy) hekurkthyes të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Bashkimi I operatorëve kanë paraqitur dy punonjës hekurkthyes me kategori të parë dhe përkatësisht punonjësit me iniciale N.S, G.L

Punonjësit e mësipërm nuk janë punonjës me kategori të III-të por me kategori të I-rë.

7.AK ka kërkuar 4(katër) murator të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Bashkimi I operatorëve kanë paraqitur katër punonjës murator me kategori të parë dhe përkatësisht punonjësit me iniciale S.Rr, G.Ll, M.D, H.Q

Punonjësit e mësipërm nuk janë punonjës me kategori të III-të por me kategori të I-rë.

8.AK ka kërkuar 5(pesë) punëtor ndërtimi të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me kategori III.

Bashkimi I operatorëve kanë paraqitur pesë punëtor ndërtimi me kategori të parë dhe përkatësisht punonjësit me iniciale N.H, P.A, R.T, A.Xh, F.T

Punonjësit e mësipërm nuk janë punonjës me kategori të III-të por me kategori të I-rë.

*Bashkimi i Operatorëve ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, **duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që AK i vlerëson të nevojshme.....**  
b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë*

organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

**Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të kualifikimit pika 5.1 është I paplotë , për rrjedhojë i pavlefshëm**

- Në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 11 citohet:

**Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë ( shtojca 9)**

<b>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri 10 ton për secilin kamion)</b>	<b>3 copë</b>	Pronësi ose me qera
<b>Fadrome me goma</b>	<b>2 copë</b>	Pronësi ose me qera
Buldozer	1 copë	Pronësi ose me qera
MotoGjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
<b>Eskavator me goma 0.25 m3</b>	<b>2 copë</b>	Pronësi ose me qera
Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë deri në 2 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Mini eskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Betonforma	1500 m2	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	2 copë	Pronësi ose me qera
<b>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri 5 ton per secilin kamion)</b>	<b>2 cope</b>	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Depozitë uji (5000)	1 copë	Pronësi ose me qera
Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë)	1500 m2	Pronësi ose me qera
Prerëse Asfalti	2 cope	Pronësi ose me qera
Aparat Saldimi	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike prodhim betoni	1 copë	Pronësi ose me qera

Rul me kompresor per ngjeshje asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Rul me Vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera

*Operatori Ekonomik “Gjiguria” shpk dhe operatori ekonomik “R&T” shpk në përmbushje të kriterit të mësipërm kanë deklaruar në shtojcën nr.9 se disponono mjetet e mëposhtëme:*

1. Kamion vetëshkarkues me targa AA851RM me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **17.2 Ton**
2. Kamion me targa AA230NZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur **për këtë mjet 7.3 Ton**
3. Kamion Vetshkarkues AA087PF me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.4 Ton**

4. Kamion Vetshkarkues AA654OZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **19.6 Ton**
5. Kamion Vetshkarkues AA334LF me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **23.5 Ton**

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamiona vetëshkarkues me **kapaciteti mbajtës për secilën kamion deri në 10 ton** dhe dy kamiona vetëshkarkues me **kapaciteti mbajtës për secilën kamion deri në 5 ton** për ekzekutimin e kontratës. Nga sa më sipër rezulton se Bashkimi I Operatorëve Ekonomik ka paraqitur në mënyrë të rregullt përsa I përket kapacitetit mbajtës vetëm dy kamiona vetëshkarkues dhe përkatësisht kamioni me targë AA230NZ dhe kamioni me targë AA087PF .Kamionat e tjerë të mësipërme të deklaruara nga bashkimi I operatorëve ekonomikë **kanë kapacitetin mbajtës mbi 5 ton si dhe mbi 10 ton për këtë fakt nuk do të konsiderohen të rregullta .**

- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Gjiguria shpk dhe R&T shpk” kanë deklaruar në shtojcën 9 fadroma copë 2 me qera me kontratat me nr.3415 rep dhe 1164 kol . Për të dy fadromat është paraqitur si dokumentacion shoqërues fatura doganore

Për mjetet e mësipërme nuk janë paraqitur çertifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit, si dhe leja e qarkullimit rrugor mosplotësimi i këtij kushti bie në kundërshtim me “Kriteret e veçanta për kualifikim”, kapaciteti Teknik pika 11, gërma (a) ku citohet:

**Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi**

Pra sa më sipër cituar për fadromat e paraqitur nga operatori ekonomik duhet detyrimisht të kishin dokumentacionin shoqërues Lejë Qarkullimi, Çertifikatë e kontrollit teknik dhe siguracion mjeti.

Bashkimi i Operatorëve ekonomik të mësipërm ka deklaruar në shtojcën 9 eskavator me goma copë 1 në pronësi i paisur me faturë doganore si dhe një eskavator me goma me qera me kontratën nr.3415 rep dhe 1164 kol për të cilin kanë paraqitur si dokumentacion shoqërues faturë doganore. Për eskavatorët me goma shoqëritë nuk kanë paraqitur lejë qarkullim, çertifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit, C’ka bie në kundërshtim me “Kriteret e veçanta për kualifikim”, kapaciteti Teknik pika 11, gërma (a) ku citohet:

**Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi**

Pra sa më sipër cituar eskavatorët me goma nuk ka lejën e qarkullimit, Çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion mjeti.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 9 , me pikën 11 është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Është kualifikuar si ofertë e suksesshme, ky ofertues :

### **1. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Ed konstruksion” shpk &” ALBA KONSTRUKSION”, kualifikohet në vend të parë.**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **216.727.812,37** ( dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind e njëzetë e shtatë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë presje tridhjetë e shtatë) . Çmimi total i ofertës me tvsh = **260.073.374,84** (dyqind e gjashtëdhjetë milion e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër presje tetëdhjetë e katër) lekë. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 17 (shtatëmbëdhjetë) muajve kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.06.2017

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Gjikuria” shpk & “R & T” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 24165 Prot. datë 19.06.2017 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: **”Ndërtim i shkollës 9-vjeçare ”Kosova” Tiranë”**

Me marrjen e ankesës nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë të mësipërm, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” me Urdhërin me Nr. 24165/1 Prot. dt. 19.06.2017, është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me Urdhërin me Nr. 24165/2 Prot. datë 19.06.2017 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi ka shqyrtuar ankesën e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, shoqërise “Gjikuria” shpk & “R & T” shpk, ka konkluduar sa më poshtë:

Nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë të mësipërm dhe është konsideruar i drejte dhe i bazuar në ligj, Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Ky konkluzion i është rekomanduar Titullarit të Autoritetit Kontraktor si dhe është vënë në dijeni bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Gjikuria” shpk & “R & T” shpk, me ane të shkresës Nr. 24165/4 datë 20.06.2017. (administruar në dosjen e prokurimit).

Më datë 03.07.2017 me anë të shkresës nr. 24165/5 është hequr pezullimi i Urdhërit pasi janë respektuar afatet e ankimit pranë KPP-së.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Ed konstruksion” shpk &” ALBA KONSTRUKSION”, me adresë:** Adresa: Tiranë, rr. Frederik Shiroka, GV-Konstruksion, Kulla C, Kat 2,ap.1/2, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH **216.727.812,37** ( dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind e njëzetë e shtatë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë presje tridhjetë e shtatë)lekë, është **identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

